



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

Datë:	03.10.2024
Referenca:	
Për :	z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	z. Diamant Bytyqi - Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar për Komunitete
Nga:	z. Valon Pacolli - Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda:	Raport për muajin Shtator - 2024

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij muaji në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

- Nënshkrimi i memorandumit në mes MINT/KIESA dhe KK Lipjan për zhvillimin e infrastrukturës së fazës V-të në ZE Qylagë
- Monitorim në implementimin e fazës së IV-të të zhvillimit të infrastrukturës në ZE Qylagë
- Angazhim në implementimin e memorandumit në mes KEDS dhe Komunës së Lipjanit për furnizim me energji elektrike ZE Qylagë
- Vizitë studimore në Francë me mbështetje të partnerit SwissContact nën kuadër të master planit për Goleshin
- Mbajtja e takimeve finale me Federatën e Aeronautikës dhe grupeve të interesit për prezantimin e master planit për Goleshin
- Mbajtja e dy debateve publike për hartimin e SZHE 2024-2029
- Finalizimi i draftit të SZHE 2024-2029

- Takime me partnerë të huaj për gjetjen e mundësive për bashkëpunim në fushën e studimit të fizibilitetit për ngrohjen qendrore të qytetit
- Takime me partnerë të huaj për gjetjen e mundësive të përkrahjes në zhvillim të ndërmarrësisë
- Plotësimi i rekomandimeve nga fusha e auditimit të brendshëm
- Përgatitje e faturave për shfrytëzuesit e pronës afatshkurtër komunale
- Përgatitje e raporteve mujore për ngarkesat e shfrytëzuesve afatshkurtër të pronave komunale, raporte këto të adresuara Sektorit-Pronësoro Juridik

STATISTIKAT

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT UDHËHIQET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Pagesa të bizneseve për ndryshime	30	
2	Biznese të reja të regjistruara	30	
3	Duplikat dhe ndrrim të qertifikatave	3	
4	Kërkesë për ndryshim të adresës	0	
5	Ndryshim të njësisë	1	
6	Vërtetim që posedon apo nuk posedon biznes	0	
7	Shuarje të biznesit	2	
8	Shtim i aktivitetit të biznesit	2	
9	Informata të bizneseve	12	
10	Ndrrim i pronarit	4	
11	Kërkesë për ndryshim të emrit të biznesit dhe emrit tregtar	1	
12	Kërkesë për ndryshim të kapitalit	1	
13	Ndrrim të tipit të biznesit	0	
14	Ndrrim të drejtorit	2	
15	Shtim emaili dhe nr.tel.	2	